



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 214 / Prot.

Tiranë, më 11.05.2015

VENDIM

Nr. 32, datë 11/5/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Z. , përfaqësuar nga Z. , sipas prokurës nr.79 Rep., nr. 28 Kol., datë 17.01.2015, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 214 datë 17.03.2015 me objekt, "Ankim për refuzimin ndaj dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", ndaj autoritetit publik/Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit(IKMT). Ankuesi në cilësinë e kërkuarit është drejtuar pranë autoritetit publik me kërkesën datë 16.02.2015, për pajisje me informacion dhe dokumentacion, sipas së cilës ka kërkuar: "Një kopje të praktikës për prishjen e objektit tre katësh në pronësi të tij, me adresë: Rr "Mihal Grameno" Tiranë, me numër pasurie 7/586 vol.36, fq.191, në zonën kadastrale 8150". Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, me urdhrin nr. 39 Prot, datë 17.03.2015, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit administrativ pranë autoritetit publik/IKMT. Gjatë inspektimit, nga titullari i IKMT-së u bë e ditur se të gjitha kërkesat sipas objektit, administrohen në IKMT Qendër dhe më pas i delegohen degëve/strukturë varësie. Në këtë rast u konstatua se autoriteti publik/ IKMT me shkresën përcjellëse nr. 1311/1 Prot., datë 02.03.2015, ka dërguar për ndjekje kërkesën objekt shqyrtimi, pranë strukturës së saj të varësisë/Degës Tirana 1 , duke cituar në të "marrjen e masave nga kjo e fundit për kthimin e përgjigjes brenda afateve ligjore". Gjithashtu, IKMT me shkresën nr.1946/1 Prot, datë 31.03.2015 ka njoftuar Zyrën e Komisionerit mbi dërgimin e kërkesës për ndjekje strukturës së saj në varësi. Nga inspektimi rezultoi se dega IKMT/Tirana 1, është përgjigjur kërkuarit/ankuesit me anë të shkresës nr. 240/2Prot., datë 10.04.2015 duke argumentuar se, "për shkak të volumit të madh të punës në sektorin tonë, jemi duke përpunuar përgjigjen për kërkesën tuaj e cila do t'ju vihet në dispozicion sa më shpejt të jetë e mundur". Përgjigja e dhënë nga struktura e varësisë së cilës i është deleguar trajtimi i kësaj kërkesë, konfirmon plotësisht legjitimitimin e pozicionit të kësaj strukture për ndjekjen dhe ecurinë e praktikës dhe njëkohësisht evidenton faktin e mbajtjes së përgjegjësisë direkte në rast të mospërmbushjes së kompetencës që duhet të ushtrojë në përputhje me shkronjën "ll" të nenit 18 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", në të cilin

shprehimisht thuhet “moszbardhja e dokumenteve zyrtare, në kundërshtim me rregullat në fuqi, me qëllim pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim, dënohet me 150.000 deri në 300.000 lekë”.

Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, në këtë rast struktura e deleguar, detyrohet sipas nenit 7, 14/2, 15, 16/2 dhe 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të trajtojë kërkesën dhe të informojë ankuesin, lidhur me informacionin e kërkuar apo nëse është rasti të refuzojë tërësisht kërkesat ose pjesërisht duke argumentuar mbi to.

Ankuesi në kërkesën e tij kërkon të marrë dokumentacionin që i përket në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përsa kohë dokumentet e kërkuara nuk i nënshtrohen zbatimit të nenit 17 të ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ato duhen bërë publike, që në këtë rast duhen vënë në dispozicion të kërkuarit. Procesverbali është nënshkruar nga grupi i inspektimit dhe përfaqësuesi i strukturës së varësisë të cilit i është deleguar trajtimi i kërkesës, ka refuzuar ta firmosë atë.

Ankuesi/Z. pas pritjes së përgjigjes nga IKMT, me anë të shkresës 05.05.2015 ka kërkuar sërish prej kësaj të fundit, duke vënë në dijeni dhe Zyrën e Komisionerit, pajisjen me dokumentacionin dhe aktet e plota që i përkasin praktikës administrative në lidhje me prishjen e godinës, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Zyra e Komisionerit, në datë 11.05.2015, ka kryer përsëri inspektim pranë IKMT. Gjatë inspektimit jemi informuar me të njëjtën përgjigje dhënë në inspektimin e mëparshëm, *se informacioni i kërkuar administrohet nga struktura e varësisë së cilës i është dërguar kërkesa për trajtim prej depozitimit të saj për herë të parë.*

Në përfundim, nga dokumentacioni i administruar, vërehet se kërkesa nuk është trajtuar nga struktura përgjegjëse brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 15/1 dhe 15/3/a të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilët respektivisht thuhet, **15/1** “Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe” dhe **15/3/a** “ Afati i parashikuar në pikat 1 dhe... mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet..a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta voluminoze”. Gjithashtu rezultoi se personi përgjegjës, në rastin objekt shqyrtimi/ përgjegjësi i sektorit Tirana 1, ka shkelur edhe parashikimin e bërë në shkronjën “II” të nenit 18 të këtij ligji, duke penguar ushtrimin e të drejtës për informim të kërkuarit të informacionit.

Në zbatim të pikës 4 të nenit 19, përgjegjësia për këtë kundërvajtje administrative është e nëpunësit i cili ka përgjegjësi administrative për moszbardhjen e dokumenteve me qëllim pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim, në rastin konkret e Përgjegjësit të strukturës së varësisë së IKMT-së/ Degës Tirana 1. Në këto kushte, ankesa duhet pranuar si e bazuar në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 4 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenit 23, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Z. nr.214 Prot, datë 13.03.2015, kundër autoritetit publik/ Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

2. Urdhërimin e autoritetit publik/ Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, për vënien në dispozicion ankuesit Z. _____, të kopjes së praktikës për prishjen e objektit tre katësh në pronësi të shtetasit _____, me adresë: Rr “Mihal Grameno” Tiranë, me numër pasurie 7/586 vol.36, fq.191, në zonën kadastrale 8150.
3. Dënimin e Z. _____, përgjegjës i Sektorit Tirana 1/ IKMT me gjobë në vlerën 150.000 (një qind e pesëdhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 19, pika 4 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 22 dhe 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Ky vendim u dha sot në datë 11.05.2015.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

REPUBLIKA E SHQIPËRI
KOMISIONI QENDRORE I DREJTËSIAVE
DHE TËMBËRIMIT